

RAPORTI I KËRKIMIT MBI VENDET E LIRA TË PUNËS NË KOSOVË

PËRGATITUR NGA: Qendra e Karrierës dhe Mirëqenies Studentore



Tabela e përmbajtjes

Hyrje	4
Pozitat më të Kërkuara të Punës	5
Vendet e Lira të Punës në Qytetet e Kosovës për Vitin 2023-2024	6
Mundësitë e Punës në Sektorë të Ndryshëm	7
Muajt me Numrin më të Lartë të Vendeve të Lira të Punës.....	8
Kriteret më të Kërkuara për Aplikantët e Punës	9
Mosha e preferuar e Aplikantëve për Pune.....	12
Preferencat Gjimore në Vendet e Lira të Punës.....	12
Punë me orar të plotë ose orar të pjesshëm	14
Preferencat në Vendodhje Fizike ose Online	15
Mundësitë e Punës: Lokale vs. Ndërkombëtare	16
Dokumentet e Nevojshme për Aplikim	17
Përmbyllje	17

Lista e figurave

Figure 1- Industritë që ofrojnë vende pune	6
Figure 2- Qytetet në Kosovë me mundësi punësimi	Error! Bookmark not defined.
Figure 3- Sektorë që ofrojnë punë në Kosovë	8
Figure 4- Shpalljet e vendeve të punës sipas muajve	9
Figure 5- Kriteret e kërkuara nga punëdhënësit	11
Figure 6- Moshat e kërkuara nga punëdhënësit	12
Figure 7- Vendet e punës sipas kriterit gjinor.....	13
Figure 8- Orari i punës	14
Figure 9- Puna në epokën e digjitalizimit	15
Figure 10- Vendndodhja e vendeve të punës	16
Figure 11- Dokumentet e nevojshme për aplikim	17

Hyrje

Në një përpjekje për të kuptuar më mirë mundësitë e punës, prezantojmë Raportin Vjetor të Vendeve të Lira të Punës.

Kemi analizuar me kujdes 1,801 njoftime pune nga portalet e punës **kosovajob.com**, **portalpune.com** dhe **ofertapune.net** për të nxjerrë njohuri të thella. Raporti hulumton shumëllojshmërinë e pozitive të punës, industrive, dhe vendeve gjeografike, duke ofruar një pamje të plotë të tregut të punës në periudhën e përcaktuar prej një viti 2023-24

Me një analizë të kujdesshme të numrit të madh të postimeve pune, synojmë të shohim trendet, preferencat dhe kërkesat brenda tregut të punës. Te dhenat përfshijnë sektorë të ndryshëm si administrata, financa, arkitektura, marketingu, shitja, arsimi, telekomunikacioni, dhe shëndetësia. Gjetjet e këtij raporti janë burim i çmuar që mund të shërbejë si udhëzues për kërkuesit e punës, punëdhënësit dhe politikanët.

Raporti ofron një vështrim të gjerë të situatës së punës, duke identifikuar pozitat më të kërkuara, kuptuar koncentrimet gjeografike të mundësive të punës dhe njohur cilësitë dhe kriteret më të rëndësishme për punëdhënësit. Në këtë rrugëtim në labirinthin e vendeve të lira të punës, synojmë të jemi një mjet ndihmues duke ofruar kuptim të rëndësishëm në botën gjithnjë e më komplekse të mundësive të punës.

Pozitat më të Kërkuara të Punës

Në përpjekjen tonë për të kuptuar kahjen e vendeve të lira të punës për vitin 2023-2024, hulumtuam 1,801 përgjigje për të dalluar pozitat më të kërkuara në tregun e punës. Përgjigjet kanë nxjerrë në pah tendencat e përhapura, duke vënë në pah pozitat që janë në kërkesë të lartë. Në gamën e ndryshme të kategorive të punëve, disa sektore kyç janë shfaqur si pikat fokale të rekrutimit:

- **Roli Administrativ:** Pozitat administrative vazhdojnë të jenë të rëndësishme në shumë industri, të cilat përfaqësojnë një bazë themelore për efikasitetin e organizatave.
- **Banka/Financa/Kontabiliteti:** Sektori financiar mbetet në thelb, me një kërkesë të vazhdueshme për profesionistë të kualifikuar në banka, financë, dhe kontabilitet.
- **Arkitektura:** Fusha e arkitekturës ka një kërkesë të vazhdueshme, duke reflektuar projektet e rritjes dhe zhvillimit në rajon.
- **Marketingu dhe Shitjet:** Pozitat në marketing dhe shitje mbeten të kërkuara shumë, duke theksuar rëndësinë e shtytjes së rritjes së biznesit përmes strategjive efektive të promovimit dhe shitjes.
- **Arsimi:** Sektori i arsimit vazhdon të jetë një kontribues i rëndësishëm për mundësitë e punës, tregues i një fokusi të vazhdueshëm në ngritjen dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor.
- **Telekomunikacioni:** Në botën gjithnjë e në ndryshim të teknologjisë, sektori i telekomunikacionit është një lojtar kyç, me një nevojë të vazhdueshme për profesionistë të kualifikuar për të shtyrë inovacionin.
- **Shëndetësia/Farmacia:** Industrinë e shëndetësisë dhe farmacisë tregojnë një kërkesë të vazhdueshme për profesionistë të kualifikuar, duke vërejtur rëndësinë e vazhdueshme të shërbimeve shëndetësore.
- **IT dhe Programimi:** Roli i Teknologjisë së Informacionit (IT) dhe programimit mbetet i rëndësishëm, duke theksuar varësinë e vazhdueshme nga teknologjia dhe zhvillimi i programeve.
- **Automobilistika/Aviacioni:** Pozitat lidhur me industrinë e automjeteve dhe aviacionit mbeten të rëndësishme, duke reflektuar rëndësinë e vazhdueshme të sektoreve të transportit.
- **Roli i Menaxherit:** Pozitat e menaxhimit, duke përfshirë menaxhimin e përgjithshëm dhe rolet


e specializuara, vazhdojnë të jenë të kyçe për suksesin e organizatave.

- **Marketingu Digjital:** Sfera e marketingut digjital po fiton rëndësi, duke treguar rritjen e rëndësisë së strategjive online në peisazhin e bashkëkohshëm të biznesit.
- **Juridiku/Ligjor:** Roli juridik dhe ligjor janë të paprekshëm, duke theksuar nevojën e vazhdueshme për ekspertizë ligjore dhe përmbushjen e standardeve në sektorë të ndryshëm.
- **Hospitaliteti/Turizmi:** Sektori i shërbimeve dhe turizmit vazhdon të jetë një kontribues i rëndësishëm për mundësitë e punës, duke përkuar me fokusin e rajonit në zhvillimin e turizmit.
- **Konsulencë/Këshillimi:** Pozitat e konsulencës dhe këshillimit janë në kërkese, tregues i nevojës për ekspertizë të specializuar për të udhëzuar organizatat nëpërmjet vendimeve strategjike.

Figure 1- Industritë që ofrojnë vende pune (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)


Vendet e Lira të Punës në Qytetet e Kosovës për Vitin 2023-2024

Në analizën tonë të vendeve të lira të punës për vitin 2023-2024 nëpër qytete të ndryshme në Kosovë,



mbledhëm të dhëna për të identifikuar rajonet ku mundësitë e punës janë më të pasura. Shpërndarja e përgjigjeve ofron njohuri për qytetet që shpallin më shumë vende të lira të punës. Këtu është një pasqyrë e qyteteve dhe shpërndarja e mundësive të punës bazuar në të dhënat e mbledhura:

Prishtinë: Qyteti kryesor, Prishtina, dallohet si qendra kryesore për vende të lira të punës, duke



reflektuar në statusin e saj si qendër ekonomike dhe administrative, duke kapur mbi 72% të përgjigjeve.

Fushë Kosovë: Ky qytet vjen i dyti, si qytet irëndësishm për vende të lira të punës dhe aktivitete ekonomike, ndikuar ndoshta nga afërsia me kryeqytetin.

Lipjan: Lipjani shfaqet gjithashtu si një qytet me shpallje të konsiderueshme të vendeve të lira të punës, duke sugjeruar një gamë të gjerë mundësishë të punës brenda ekonomisë së tij lokale.

Pejë, Podujevë dhe Prizren: Këto qytete shfaqen me një numër të konsiderueshëm të vendeve të lira të punës, duke nënvizuar shpërndarjen rajonale të mundësive të punës në pjesë të ndryshme të Kosovës.

Qytete të tjera: Përveç kësaj, qytete të ndryshme të tjera, si Gjakovë, Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë, kontribuojnë në peizazhin e përgjithshëm të vendeve të lira të punës, duke treguar shfaqjen e aktiviteteve ekonomike të ndryshme nëpër gjithë Kosovën.

Figure 2- Qytetet në Kosovë me mundësi punësimi (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)

Mundësitë e Punës në Sektorë të Ndryshëm

Duke analizuar tregun e punës për vitin 2023-2024 në qytetet e Kosovës, hulumtimi ynë përqëndrohet në shpërndarjen e mundësive të punës nëpër sektorë të ndryshëm, përfshirë Sektorin Publik, Sektorin Privat dhe Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ).

Nga përgjigjet e 1,793 pjesëmarrësve, kemi fituar njohuri të vlefshme në prevalencën e vendeve të lira të punës në këto sektorë të ndryshëm.

Gjetjet zbulojnë se Sektori Privat dominon tregun e punës, duke përfshirë një pjesë të rëndësishme të përgjigjeve. Me 96.9% të pjesëmarrësve që tregojnë për mundësi në Sektorin Privat, ku theksohet roli kryesor i ndërmarrjeve private në shtytjen e punësimit në Kosovë.

Sektori Publik, ndonëse i rëndësishëm, përbën një pjesë më të vogël, me 2.6% të përgjigjeve që përmendin vende të lira të punës në qeveri dhe institucione të ngjashme. Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) gjithashtu japin një kontribut në peizazhin e punës, por paraqesin një pjesë relativisht të vogël, duke llogaritur 0.7% të mundësive të raportuara për punë.

Këto të dhëna ofrojnë një kuptim të dinamikave të punësimit në Kosovë, duke theksuar domethënien e Sektorit Privat në krijimin e vendeve të punës dhe rëndësinë e një game të ndryshme sektorësh në kontributin e tyre në ekosistemin e përgjithshëm të punësimit.




Figure 3- Sektorë që ofrojnë punë në Kosovë (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)

Muajt me Numrin më të Lartë të Vendeve të Lira të Punës

Në raportin vjetor për vitet 2023-24, jemi përpjekur të hulumtojmë dinamikën e vendeve të lira të punës në tregun e punës në Kosovë, duke analizuar shpalljet e punës nëpër disa portale. Të dhënat e grumbulluara tregojnë se ofertat e vendeve të lira të punës ndryshojnë përgjatë muajve të vitit, duke na ofruar një perspektivë të qartë mbi momentet kur ka një koncentrim të lartë të mundësive të

punës.

Në analizën tonë, bëhet e dukshme se muaji mars dallohet si një periudhë shumë e rëndësishme me një shtim të dukshëm në numrin e vendeve të lira të punës. Kjo rritje sugjeron se në sektorin e tregut të punës në Kosovë, ka një aktivitet të përforcuar rekrutimi gjatë kësaj periudhe, ndoshta si rezultat i kërkesave sezonale, cikleve të planifikimit strategjik, apo konsideratave të tjera të biznesit.

Gjithashtu, muajt e fillimit dhe fundit të vitit, si janari dhe dhjetori, shfaqen si momente kryesore me një numër të rëndësishëm të vendeve të lira të punës. Këto periudha mund të jenë ndikuar nga faktorë si fillimi i vitit fiskal, përfundimi i projekteve apo planifikimi i aktiviteteve të reja.




Figure 4- Shpalljet e vendeve të punës sipas muajve (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)

Kriteret më të Kërkuara për Aplikantët e Punës

Në analizën e 1,635 konkurseve të punës lidhur me kriteret më të kërkuara në vende të lira pune, kanë dalë disa tendenca kyçe. Anketa hulumton faktorët që punëkërkuarit i shohin si themelorë kur shqyrtojnë mundësitë në tregun e ri të punës. Të dhënat, të kategorizuara në sfondin arsimor, përvojën e punës, njohuritë gjuhësore dhe aftësitë e tjera, ofrojnë njohuri të vlefshme për punëdhënësit dhe menaxherët e rekrutimit që duan të tërheqin talente të shquara.

Fondi Arsimor:

Anketa thekson rëndësinë e kualifikimeve arsimore në procesin e kërkimit të punës. Një pjesë e konsiderueshme e aplikimeve për vende të lira pune, rreth 750, theksuan se një diplomë Bachelor

është një kriter themelor për ta. Sidoqoftë, një numër imponues prej 500 përgjigjeve shprehu një preferencë për kandidatët me diploma Master, duke treguar një trend rritës të edukatës së avancuar si një dallues në tregun e punës. Kjo thekson nevojën që organizatat të njohin dhe vlerësojnë kandidatët me sfonde arsimore të ndryshme.

Përvoja e Punës dhe Trajnimet:

Në lidhje me përvojën e punës, rezultatet tregojnë se një numër i konsiderueshëm i shpalljeve të punës, rreth 1,000, vlerësojnë kandidatët me përvojë të rëndësishme pune. Të dhënat theksojnë gjithashtu rëndësinë e trajnimeve dhe certifikatave, me rreth 250 aplikimeve që kishin si kriter kandidatë të pajisur me certifikata dhe programe trajnimi specifike. Kjo thekson rëndësinë e rritur të mësimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional në sytë e punëkërkuësve.

Njohuritë Gjuhësore dhe Aftësitë Teknike:

Anketa identifikon njohuritë gjuhësore si një faktor kritik për punëkërkuësit, me 500 përgjigje që theksojnë rëndësinë e aftësive gjuhësore të huaja. Gjithashtu, të dhënat tregojnë një interes të vecantë për kandidatë me aftësi të forta kompjuterike, siç dëshmon numri prej 1,250 punëdhënësish që e vendosin këtë atribut në plan të parë.




Figure 5- Kriteret e kërkuara nga punëdhënësit (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)


Mosha e preferuar e Aplikantëve për Pune

Ky raport për vende të lira pune hulumton preferencat e moshave të shprehura nga punëdhënës kur kërkojnë persona për të punësuar. Për të kuptuar demografinë e moshave të kërkuara nga punëkërkesit është thelbësore për punëdhënësit që synojnë të pajisin strategjitë e tyre të rekrutimit me preferencat e mundshme të kandidatëve. Anketa kategorizon moshat në gjashtë grupe: 18-25, 25-30, 35-40, 40-45, 45-50 dhe një kategori që për punëdhënës që nuk kanë preferencë moshe për të punësuarit potencial. Të dhënat e marrura ofrojnë njohuri të vlefshme në dinamikën e preferencave të lidhura me moshën në tregun e punës.

Preferencat e Moshave:

Përgjigjet zbulojnë preferenca të ndryshme të punëdhënësit në lidhje me kërkesat për moshat në pozitë të lira. Një pjesë e ndjeshme prej 2.3% bie në grupmoshën 18-25 vjeç, duke treguar një entuziazëm të konsiderueshëm të individët e rinj në fuqi pune. Përveç kësaj, ka një përfaqësim të rëndësishëm në grupmoshën 25-30 vjeç, që përbën 1.7% të moshës së kërkuar. Është vërejtje e rëndësishme se një pjesë e punëdhënësve nuk specifikojnë një grupmoshe të preferuar, duke theksuar nevojën për fleksibilitet në praktikën e rekrutimit për të akomoduar një shkallë të gjerë të grupmoshave.

Figure 6- Moshat e kërkuara nga punëdhënësit (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)



Preferencat Gjinore në Vendet e Lira të Punës

Kjo pjesë e raportit për vende të lira pune eksploron preferencat e 1,698 pjesëmarrësve në lidhje me gjininë në njoftimet e punës. Për të kuptuar këto dinamika është thelbësore për punëdhënësit që kërkojnë ambiente të përfshira. Përgjigjet janë kategorizuar në Femra, Meshkuj, Nuk Specifikohet, dhe një opsion për ata që preferojnë të dy gjinitë.

Të dhënat zbulojnë modelet interesante të preferencave gjinore të punëkërkuësve. 12.7% preferojnë kandidatë femra, duke njohur kontributet e çmuara që femrat sjellin në fuqinë e punës. Në të njëjtën kohë, 28.3% preferojnë kandidatë meshkuj, duke treguar për opinionet e ndryshme. Kryesisht, 32.9% nuk specifikojnë një preferencë, duke theksuar rëndësinë e konsiderimit të aftësive, pavarësisht nga gjinia.

Kategoria "Te dyja" (Dy Gjinat), e zgjedhur nga 25.6%, tregon hapësirë ndaj kandidatëve të çdo gjinie. Kjo reflekton një perspektivë në rritje për përfshirjen gjinore, duke shtyrë punëdhënësit të adoptojnë politika që promovojnë mundësi të barabarta.

Në përfundim, të dhënat theksojnë nevojën për punëdhënësit të kuptojnë preferencat e ndryshme gjinore. Krijimi i njoftimeve që përqendrohen në meritë promovon ambiente pune që vlerësojnë diversitetin dhe ofrojnë mundësi të barabarta, pavarësisht nga gjinia.




Figure 7- Vendet e punës sipas kriterit gjinor (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)

Punë me orar të plotë ose orar të pjesshëm

Në këtë seksion të raportit për vende të lira pune, hulumtojmë preferencat e orarit të punës , një orar të plotë apo një orar të pjesshëm. Kuptimi i këtyre preferencave është jetik për punëdhënësit që dëshirojnë të përshtatin ofertat e punës me pritjet dhe nevojat e kandidatëve potencialë.

Të dhënat zbulojnë tendenca të qarta në preferencat e orarit të punës midis përgjigësve. Një pjesë e rëndësishme e shpalljeve të vendeve të punës, 98.7%, kanë kriter një orar të plotë. Kjo preferencë përputhet me kuptimin tradicional të punës stabile dhe të vazhdueshme, shpesh të kërkuar për sigurinë financiare dhe rritjen e karrierës.

Në anën tjetër, 1.3% e shpalljeve të vendeve të punës kanë kriter një orar të pjesshëm, duke theksuar një pjesë të konsiderueshme të fuqisë punëtore që kërkojnë fleksibilitet. Individët që zgjedhin orare të pjesshme mund të kushtojnë prioritet balancës së jetës së punës, studimeve shtesë, apo kanë përgjegjësi personale.




Figure 8- Orari i punës (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)

Preferencat në Vendodhje Fizike ose Online

Ky seksion i raportit për vende të lira pune shqyrton preferencat në 1,796 njoftime pune, duke u fokusuar nëse ato i kushtojnë prioritet pranisë fizike apo angazhimit online. Bazuar në të dhënat nga portalet online të punës, anketa ofron njohuri të vlefshme në peisazhin e punës në zhvillim.

Të dhënat zbulojnë një nuancë të preferencave në mes të njoftimeve, me 97.7% që theksojnë strukturat tradicionale të punës në vend, në përputhje me natyrën bashkëpunuese dhe të strukturuar të punës fizike. Në kundërshtim, 2.3% e postimeve pune preferojnë mundësitë online, duke pasqyruar një interes të konsiderueshëm në fleksibilitetin dhe avantazhet e punës në distancë.

Për të theksuar avantazhet e një hapësire fizike apo për të nxjerrë në pah fleksibilitetin online, përshtatja e ofertave të punës me këto preferenca ndihmon në ndërtimin e një fuqie pune të prirur për pajtueshmëri me shumë forma të punës, duke përmbushur pritjet e profesionistëve të sotëm në periodën digjitale.




Figure 9- Puna në epokën e digjitalizimit (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)

Mundësitë e Punës: Lokale vs. Ndërkombëtare

Ky seksion shqyrton preferencat në 1,794 njoftime pune, me fokus në vendndodhjen e mundësive të punës në treg vendor apo ndërkombëtar. Bazuar në të dhënat nga portalet online të punës, anketa ofron njohuri të vlefshme në dinamikën globale të preferencave të punës.

Të dhënat zbulojnë një ndarje të qartë në preferencat e njoftimeve të punës. 89.3% e postimeve pune ofrojnë mundësi lokale, duke theksuar rolet brenda vendit. Në kundërshtim, 10.7% ofrojnë mundësi ndërkombëtare, duke treguar një segment të fuqisë punëtore që kërkon role përtej kufijve kombëtarë.

Punëdhënësit mund t'i përdorin këto njohuri me strategji kur hartojnë njoftimet e vendeve të lira pune online, duke përshtatur mesazhet për tërheqjen e kandidatëve bazuar në shtrirjen e përcaktuar të pozitive.




Figure 10- Vendndodhja e vendeve të punës (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)

Dokumentet e Nevojshme për Aplikim

Ky seksion ofron shqyrtime nga 1,801 njoftime pune mbi dokumentet më të kërkuara për aplikim. Anketimi, bazuar në të dhënat e mbledhura nga portale të punës online, nxjerr ne pah dokumentet kryesore që punëdhënësit kërkojnë nga kandidatët potencial në procesin e aplikimit.

Të dhënat përcaktojnë dokumentet më të kërkuara, ku 500 njoftime pune theksojnë nevojën për një letër motivimi të personalizuar që përputhet me kërkesat specifike të pozicionit. Po ashtu 1,000 njoftime rrisin rëndesinë e një CV-je të përgjithshme, duke treguar vlerën që punëdhënësit i kushtojnë përvojës profesionale, aftësive dhe kualifikimeve të kandidatit.

Në kontekstin e dokumenteve të aplikimit, 1,500 njoftime pune tregojnë se shumë punëdhënësit kërkojnë materiale shtesë përveç letrës së motivimit dhe CV-së. Ky reflektim i pritshmërive që evoluojnë thekson rëndësinë e një aplikimi të plotë, që mund të përfshijë porfolio, letrat e referimit, ose dokumente të tjera të nevojshme për të shfaqur aftësinë e kandidatit për vendin e punës.




Figure 11- Dokumentet e nevojshme për aplikim (Burimi: Anketimi nga Zyra e Karrierës, Universum)

Përmbyllje

Në përfundim të këtij raporti për vende të lira pune, të dhënat që dalin nga studimi i njoftimeve të punës në portale online, ofrojnë një pamje të përgjithshme të tregut të zhvillimit të rekrutimit. Të dhënat e mbledhura nga mijëra postime pune ofrojnë informacion të vlefshëm për punëdhënësit dhe

kërkuesit e punës, duke hedhur dritë mbi preferencat, trendet dhe pritshmëritë që formojnë tregun e sotëm të punës.

Anketimi ka zbuluar që punëdhënësit duhet të marrin në konsideratë kur përgatitin njoftime pune. Nga kufizimet e preferuara të moshës, oraret e punës dhe vendet e punës deri te dokumentet kryesore të kërkua gjatë procesit të aplikimit, kuptimi i këtyre faktorëve është jetik për punëdhënësit që kërkojnë të tërheqin dhe mbajnë talente të njohura.

Për kërkuesit e punës, ky raport shërben si një udhëzues, duke ofruar shpjegime të vlefshme mbi prioritetet dhe pritshmëritë e punëdhënësve. Qoftë duke përshtatur dokumentet e aplikimit për t'i përputhur me standardet e industrisë, apo duke kuptuar preferencat e ndryshme të punëdhënësve në lidhje me modalitetet e punës, këto informacione i fuqizojnë kërkuesit e punës që të paraqiten si kandidatë të fortë në një treg me konkurrencë.

Me evoluimin e vazhdueshëm të tregut të punës, pritshmëria bëhet një faktor kritik për të dyja palët, punëdhënësit dhe kërkuesit e punës. Punëdhënësit inkurajohen të përdorin të dhënat e anketimit për të përmirësuar strategjitë e tyre të rekrutimit, duke siguruar që të mbeten konkurrues dhe të përputhen me pritjet e fuqisë punëtore. Në anën tjetër, kërkuesit e punës mund të përdorin këtë informacion për të përmirësuar kuptimin e tyre të preferencave të punëdhënësve dhe për të përshtatur qasjen e tyre për të dalë në një fushë të ngarkuar.

Në thelb, ky raport shërben si një kompas për navigimin në tregun dinamik të rekrutimit, duke ofruar shpjegime të vlefshme që kontribuojnë në efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të punësimit. Duke pranuar këto gjetje, punëdhënësit dhe kërkuesit e punës mund të marrin pjesë aktivisht në formimin e të ardhmes së rekrutimit, duke nxitur një treg të punës më transparent, më përfshirës dhe përfitues për të gjithë.